



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 74 Prot.

Tiranë më 21/07/2020

VENDIM

Nr. 24, Datë 21.07.2020

**“PËR MIRATIMIN E NUMRIT DHE FORMATEVE TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR
ZGJEDHJEN E AUTORITETEVE DHE ORGANEVE DREJTUESE NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Komisioni Institucional Zgjedhor në mbledhjen e datës 21.07.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë modelet e fletëve të votimit me emrat përfundimtarë të kandidatëve për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë:
 - A. **Fletë votimi të kategorisë – Personel Akademik për Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Mjekësisë Dentare dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.**
 - Fletë votimi për Rektor
 - Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Kryesore
 - Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Bazë
 - Fletë votimi për Anëtarë në Senatin Akademik
 - B. **Fletë votimi të kategorisë – Studentë për Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Mjekësisë Dentare dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.**
 - Fletë votimi për Rektor
 - Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Kryesore
 - Fletë votimi për Anëtarë në Senatin Akademik (përfaqësues të studentëve të UMT-së)

2. Të bashkëlidhë këtij vendimi, modelet e fletëve të votimit (37 - tridhjetë e shtatë modele) për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
3. Të miratojë numrin total të fletëve të votimit sipas modelit dhe numrit serial, të cilat do të prodhohen në blloqe pa kundërfletë sipas kategorive që do të përdoren për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë kodet e njësive bazë që vendosen në numrin serial të fletës së votimit për drejtues të njësive bazë në përputhje me tabelën 2, bashkëlidhur këtij vendimi
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në mjediset e Universitetit, dërgohet pranë KZF dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit .

KRYETAR
SILVANA BALA

